REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 47-48/23
Datë/Datum. 03.05.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr 47/23
48/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Agon Ramadani - Kryetar, Vedat Poterqoi – Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga OE: PROFITECH shpk -Prishtinë kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pjese për MRRK ne TCA Lot1 Signalizator ne hinka elektromagnetike Signalizator për gëlqere termoelemente ,poqe sinjalizuese dhe elemente si dhe ankesës së NTSH "MONT ELEKTRO" sh.p.k.- Prishtinë, kundër vendimit për anulim të procedurës për Lot3 Rregullator te temperaturës ,termometër bymetal, rregullator i presionit dhe shkarkues i kondezatit , Senzor i shtypjes 0-1 bar dhe kutia furnizuese me valvave" me nr. prokurimi: KEK22-2966-1-1-1 dhe numër te brendshëm: KEKO 22-086-111, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues (duke ju referuar më poshtë si AK) Korporata Energjetike e Kosovës sh.a Prishtinë , më datën: 03.05.2023, morri këtë:

V E N D I M

I. **Anulohen në tërësi,** në mungesë të ofertave të përgjegjshme lotet për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pjese për MRRK ne TCA Lot1 Signalizator në hinka elektromagnetike Signalizator për gëlqere termoelemente ,poqe sinjalizuese dhe elemente ,Lot3 Rregullator te temperaturës ,termometër bymetal, rregullator i presionit dhe shkarkues i kondezatit , Senzor i shtypjes 0-1bar dhe kutia furnizuese me valvave" me nr. prokurimi: KEK22-2966-1-1-1 dhe numër te brendshëm:

KEKO 22-086-111, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga AK Korporata Energjetike e Kosovës sh.a Prishtinë.

II. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

IV. Me qenë se lotet janë anuluar në tërësi, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës OE-ve ankues në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Me datë 20.01.2023. OE "PROFITECH Shpk" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 47/23, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "MONT ELEKTRO Shpk"- Prishtine. lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me pjesë për MRRK në TCA": LOT.1: Signalizator të hirit në hinka. Valva elektromagnetike, Signalizator për gelqere, termoelement, poqa sinjalizuese dhe elemente matëse" me nr. të prokurimit: KEK-22-2966-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

Me datën: 20.01.2023. OE "MONT ELEKTRO Shpk" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 48/23, kundër njoftimit për anulimin e procedures se prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Fumizimi me pjesë për MRRK ne TCA-LO3- Rregullator te temperatures, Termometra bymetal, Rregullatori presionit dhe shkarkues i kondenzatit, Senzor i shtypjes 0-1 bar, dhe Kutia furnizuese me actuator per furnizim te Valvave" me nr. të prokurimit: KEK-22-

2966-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: Lot 1: 51.400.00 € (me TVSH): Lot.3: 54.500,00 € (me TVSH) €.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 dhe 114, të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër i cili me 31 janar 2023, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

"Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura. eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE PROFITECH Shpk të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe njekohesisht rekomandoj që të anulohet aktiviteti i prokurimit duke pas parasysh se OE të mbetur në këtë procedurë janë vlerësuar si të papërgjegjshëm.
Ndërsa sa i perket ankesës së OE MONT ELEKTRO Shpk duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendurs, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi njoftimi për analimin e aktivitetit të prokurimit."

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur pa praninë e palëve, konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie te kontratës B58 , njoftimi për anulim, kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ka gjetur mbështetje në ekspertizën e ekspertit shqyrtues në të cilën janë trajtuar pretendimet të natyrës teknike, dhe sipas të cilës rekomandohet anulimi i tërësishëm i dy lotëve të sipër-përmendura, andaj përfundimisht PSH

konstaton se lidhur me lot 1,OE ankues si dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk plotësojnë kërkesat e DT si dhe specifikimet teknike andaj rrjedhimisht nuk janë të përgjegjshëm për këtë aktivitet prokurimi, e poashtu lidhur me lot 3, PSH konstaton se OE ankues nuk ka arritur të dëshmojë se plotësohen specifikat dhe kërkesat relevante, andaj duke pasur parasysh të gjeturat e ekspertit të natyrës teknike, e poashtu kronologjinë e këtij aktiviteti ku objekt shqyrtimi ka qenë edhe me parë në OSHP, konstatohet se në mungesë të ofertave të përgjegjshme anulohen në tërësi lotët e sipër-përmendura, poashtu PSH konsideron se deri tek situata e tillë poashtu kanë ndikuar kriteret dhe specifikat e hartuara nga AK, që bazuar në rezultatet që janë ofruar mund të vërehet se kemi pasur të bëjmë me kërkesa padrejtësisht të rrepta që si rrjedhojë asnjë nga OE ofertues nuk kanë arritur ti plotësojnë, andaj edhe u vendos në këtë menyrë lidhur me pikën IV të dispozitivit, për faktin se PSH konsideron se anulimit të lotëve gjithashtu u ka kontribuar mënyra e hartimit të DT dhe NJK, që është në përgjegjësinë e AK-së, kështu që në rast të ritenderimit, udhëzohet AK të ketë kujdes të shtuar në përpilimin e DT dhe kërkesave të saj në mënyrë që ato të mos jenë në kundërshtim me tiparet themelore të LPP-së që janë diskriminimi, efikasiteti, zgjerimi i konkurrencës e poashtu që DT të përpilohet konform neneve 27 dhe 28 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi

Kryesues i Panelit Shqyrtues

z. Agon Ramadani

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Korporata Energjetike e Kosovës sh.a Prishtinë

1x1 OE NTSH "MONT ELEKTRO" sh.p.k. Rr. Hizri Talla- Prishtinë

1x1 OE "PROFITECH" sh.p.k. - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.